



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.07.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.07.07.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës ", Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K. e dt.22.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës ", Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211, Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 17.06.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 17.06.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.22.07.2022, Operatori Ekonomik " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës " , Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues konsideron që kërkesat e vendosura në FDT, nuk kanë elemente diskriminuese e favorizues për një operator ekonomik,

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës